

## PROJEKTILIGJI “PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”

**Komente dhe rekomandime**

## ***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

### **Të përgjithshme**

Në shumë vende furnizuesit dhe blerësit duhet të integrojnë sistemet e transaksioneve të bizneseve të tyre në një platformë softuerike të kontrolluar nga një organ tatimor. Kjo lëvizje drejt asaj që ICC e quan "kontroll të vazhdueshëm të transaksioneve" ka qenë fillimi i një revolucioni të heshtur global në lidhje me pajtueshmërinë fiskale.

Kjo tendencë po krijon një dinamikë interesante ku sistemet dhe proceset komplekse të biznesit duhet të përshtaten me sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të dizajnuara nga sektori publik.

Ne e konsiderojmë këtë tendencë si një temë kryesore strategjike për biznesin, me potencial të madh për të rritur efikasitetin e biznesit dhe veprimtarinë qeveritare në përgjithësi. Fatkeqësisht, aktualisht ekzistojnë rreziqe të larta dhe kosto thelbësore për kompanitë, duke krijuar ndërlikime më të gjera ekonomike, për shkak të mungesës së koordinimit midis qeverive që prezantojnë platforma të tilla të kontrollit të vazhdueshëm të transaksioneve.

Për këtë arsye është e rëndësishme që qeveritë të krijojnë një kuadër sa më të plotë dhe të qartë, duke marrë kohën e nevojshme në konsultim të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe aktorët e tjerë, të shtrirë në sektorë dhe zona të ndryshme të vendit me qëllim krijimin e një mjedisi sa më të thjeshtë dhe efikas për zbatimin e parashikimeve ligjore.

### **Komente të përgjithshme për ligjin**

Afati i caktuar për hyrjen në fuqi të këtij ligji data 1 janar 2020 konsiderohet si I PAREALIZUESHËM dhe i PARAKOHSHËM nga ana e bizneseve dhe palëve të interesit të përfshira në proces. Në mënyrë që bizneset të përshtasin mënyrën e punës dhe pajisjet apo zhvillimet softuer që përkojnë me kërkesat e ligjit, është e nevojshme që procesi të jetë i plotë, shterues dhe të zbatohet brenda një kohe të arsyeshme. Disa nga vështirësitë që do të përbëjnë sfida për zbatimin e këtij projektligji sipas kushteve aktuale janë:

- Pamjaftueshmëria e infrastrukturës së rrjetit kabllor.
- Ndryshimet e nevojshme në kapacitetet e serverave të biznesit.
- Ndryshime të pajisjeve fiskale nga ana e bizneseve.
- Ndryshim të kontratave me Providerat e internetit nga ana e bizneseve, nëse rriten volumet e transmetimit.
- Ndikim në kosto dhe kohë shtesë, nëse softuer apo mirëmbajtësit e kontraktuar nuk çertifikohen nga AKSHI dhe kërkohet të përzgjidhet një tjetër.
- Kohë për përshtatje të sistemeve të cilat mund të ndërveprojnë me ndërfaqen e tatimeve nga ana e zbatuesve dhe mirëmbajtësve.
- Përshtatja e duhur e formatit të faturës me kërkesat e reja për vendosje të NIVF e NSLF.

Ndaj sugjerojmë që afati DUHET TË SHTYHET me të paktën një vit, me qëllim që të gjithë palët e interesit të jenë të përfshirë në proces dhe të reflektojnë në kohë të gjitha ndryshimet që kërkohen përmes këtij ligji.

## Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”

### KOMENTE DHE SUGJERIME

#### ➤ Neni 3: Përkufizime

- e) “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës” (NSLF) dhe “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese” (NSLFSH), janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese. Këto të dhëna i gjeneron sistemi i lëshuesit të faturës dhe faturës shoqëruese, nëpërmjet të cilit verifikohet lidhja ndërmjet lëshuesit të faturës dhe faturës së lëshuar ose ndërmjet lëshuesit të faturës shoqëruese dhe faturës shoqëruese të lëshuar.

Koment për sqarim: Nuk është e qartë përmes përkufizimit nëse sistemi kompjuterik i kompanisë do të gjenerojë një numër unik apo ky numër do të jepet nga organi tatimor?

Në vitin pasardhës fiskal a do të rifillohet numërimi nga numri 1 apo do jetë në vazhdimësi?

- h) “Operatori” është individ i cili përpilon dhe lëshon faturat nëpërmjet sistemit fiskal ose personi i autorizuar nga tatimpaguesi i lëshimit të faturave për të lëshuar fatura nëpërmjet sistemit fiskal. Në rastet e shitjeve nëpërmjet pajisjes së vetëshërbimit (automat), operator konsiderohet tatimpaguesi që lëshon faturën. Në rastet e lëshimit të faturës shoqëruese, operatori është individ i cili lëshon faturën shoqëruese nga pajisja elektronike.

Koment: Në kompanitë e mëdha të retail ku imputer të shitjeve në sistem janë me dhjetëra persona dhe me qarkullim relativisht të lartë të stafit është e vështirë të menaxhohet regjistrimi i tyre në databazë për çdo herë.

Rekomandim: Propozojmë që për sistemin e tatimeve, operator të konsiderohet pika e shitjes dhe përgjegjësinë për personat fizikë që bëjnë imputet t’u mbajë kompania.

- l) “Platforma qendrore e faturave” e cila krijohet, zhvillohet, mirëmbahet dhe ....

- ii. ndërfaqja që mundëson ose menaxhon shkëmbimin e faturave elektronike në përputhje me këtë ligj.

Koment për sqarim: Ku do të merret informacioni teknik për ndërfaqen me Platformën qendrore të faturave?

Si do të veprohet në rastet kur softuer që përdor kompania nuk lidhet me ndërfaqen ose lidhja kërkon zhvillim nga kompania?

#### ➤ Neni 8: Momenti i lëshimit të faturës

- 5) Fatura mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime mallrash ose shërbimesh, të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt ose të vazhdueshme, të realizuara midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij në të njëjtin muaj, në të cilin furnizimet janë kryer. Në këtë rast, fatura lëshohet jo më vonë se dita e fundit e muajit përkatës për të gjitha furnizimet e kryera gjatë muajit.

## ***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

Koment për sqarim: Për cilat mallra zbatohet ky nen? Pika 8 thotë që për mallrat që furnizohen me transport, fatura lëshohet menjëherë para transportit?

Rekomandim: Rekomandojmë që të qartësohet kjo çështje me qëllim që të mos krijohet konfuzion mbi interpretimin e momentit të lëshimit të faturës.

### **➔ Neni 9: Të dhënat e përgjithshme të faturës**

*m) kodin QR që përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzim të Ministrit përgjegjës për financat.*

Koment për sqarim: A do të mund të jetë i editueshëm formati në mënyrë që kompania t’a personalizojë me logo?

Nëse sistemi softuerik i kompanisë gjeneron një format të ndryshëm nga ai i kërkuar, por me të gjithë elementet përbërës të faturës, a do të mundet të transmetohet në ndërfaqen e platformës së tatimeve?

*3) Çdo dokument në letër ose formë elektronike që ndryshon dhe i referohet në mënyrë specifike dhe të qartë faturës fillestare, konsiderohet faturë.*

Koment për sqarim: Edhe nëse ky dokument nuk ka të gjithë elementet e kërkuar në faturë, a do do konsiderohet si faturë?

### **➔ Neni 14: Regjistrimi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe i pajisjeve elektronike e faturimit**

*dh) orarin ditor të punës dhe ditët e punës gjatë javës, punën gjatë festave zyrtare;*

Koment për sqarim: A mund të lëshohen fatura jashtë orarit zyrtar të punës?

Sugjerim: Sugjerojmë që orari të përcaktohet qartë.

### **➔ Neni 15: Regjistrimi i operatorëve**

*Tatimpaguesi që lëshon fatura, detyrohet që të paraqesë në administratën tatimore nëpërmjet shërbimit elektronik të dhënat për çdo operator, në përputhje me nenin 3, pika “h”, e këtij ligji, përfshirë informacionin mbi numrin unik të identifikimit dhe emrin e operatorit, por jo më vonë se 24 orë para lëshimit të faturave nga secili operator.*

Koment: Vlen i njëjti koment si në nenin 3(h). Në kompanitë e mëdha të retail ku imputer të shitjeve në sistem janë me dhjetëra persona e me qarkullim relativisht të lartë të stafit është e vështirë të manaxhohet regjistrimi i tyre në databazë për çdo herë.

Rekomandim: Propozojmë që për sistemin e tatimeve operator të konsiderohet pika e shitjes dhe kompania të mbajë përgjegjësinë për personat fizikë që bëjnë imputet.

## ***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

### **➔ Neni 16: Regjistrimi i prodhuesve dhe mirëmbajtësve të softuerëve**

- 1) *Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të zgjidhjeve softuerike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve softuerike të përcaktuar në nenin 3, pika “gj”, nënpikat “ii” dhe “iii” të këtij ligji, duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike në regjistrin e prodhuesve dhe mirëmbajtësve softuerikë të AKSHI-t duke përdorur platformën qenderore e faturave të kësaj të fundit.*

Koment për sqarim: Nëse prodhuesi ose mirëmbajtësi është i huaj, a duhet të krijojë entitet juridik në Shqipëri, apo mund të regjistrohet në AKSH me të dhënat e vendit të origjinës?

### **➔ Neni 17: Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes**

- 2) *Çdo tatimpagues që lëshon faturë detyrohet që të shqyrtojë të dhënat në librin e shitjes dhe librin e blerjes të përmendur në pikën 1 të këtij neni, deri në ditën e 10 të muajit, për muajin paraardhës, dhe nëse është e nevojshme t’i ndryshojë ose përditësojë ato të dhëna, me përjashtim të vlerave, si dhe pas përfundimit të kësaj procedure, të konfirmojë saktësinë e të dhënave.*

Koment për sqarim: Nëse blerësi ka pretendime për vlerën e faturuar apo malli ose shërbimi nuk është në cilësinë e dakordësuar, a mund t’a përjashtojë faturën nga libri i blerjes edhe pse shitësi nuk vepron nga ana e tij?

- 4) *Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave në librin e shitjes dhe librin e blerjes dhe procedurat e tjera të përcaktuara nga ky nen.*

Sugjerim: Duhet të ketë një parashikim për sa i përket rasteve kur pala të cilës i lëshohet fatura nuk ka firmosur faturën pasi mund të ketë pretendime. Njëra palë e deklaron faturën, por tjetra ende jo.

Koment për sqarim: Si veprohet në këtë rast?

### **➔ Neni 20: Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës**

- 5) *Vetëm pas zbatimit të procedurës së fiskalizimit, mund të lëshohet fatura dhe t’i dorëzohet blerësit, ndërsa NIVF, si një e dhënë e detyrueshme në faturë, nënkupton që procedura e fiskalizimit është kryer me sukses. Përjashtimisht, një faturë mund të lëshohet pa NIVF, vetëm në rastet e përmendura në nenet 29, 30 dhe 31, të këtij ligji.*

Koment për sqarim: Klienti duhet të presë sa të mbarojë i gjithë procesi i konfirmimit apo kjo bëhet automatikisht gjatë ekzekutimit të printimit?

Si veprohet në rastet kur serveri i tatimeve që lëshon NIVF është i ngarkuar dhe nuk reagon në kohë? Si zgjidhet kjo situatë? A duhet prituri deri sa të bëjë fiskalizimin?

## ***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

Kjo vonesë paraqet një problematikë dhe ka një ndikim shumë të madh për një biznes i cili lëshon me mijëra fatura në ditë?

Subjektet e retail që shesin tek konsumatori fundor në vlera më pak se 40,000 lekë lëshojnë në ditë nga 200-1000 kupona për kasë fiskale. Aktualisht, këto konvertohen në një faturë të vetme shitje dhe në librin e shitjes zë vëllimin e një shitjeje të vetme. Nëse gjithë këto shitje do shkojnë të veçanta në libër të shitjes është e pamundur që kompanitë të menaxhojnë këtë fluks të detajuar informacioni. Kompanitë do të duhet të investojnë në servera e IT për të përballuar këtë shtim vëllimi të informacionit. Gjithashtu a kanë serverat e Tatimeve kapacitete të parashikuara për këto volume transaksionesh?

Gjithashtu bizneset e shërbimeve si Bar-Kafe, apo dyqanet e bukës që lëshojnë kupona 80-100 lekë do duhet të investojnë në sisteme e servera për të mbajtur kontabilitetin e tyre kur aktualisht mund ta mbajnë vetëm me një PC.

**Sugjerim:** Sugjerojmë që për këto shitje të gjenerohet një NIVF e vetme në fillim të ditës. Pasi të jetë fiskalizuar kjo faturë e parë, të gjithë faturat e tjera të dërgohen automatikisht në serverin e tatimeve me të njëjtin NIVF e të akumulohen në një faturë të vetme shitje ditore.

*10) Procedura e fiskalizimit të faturës për importet e mallrave, në rastin e pranimi të faturës së shitësit i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 7 të këtij neni, kryhet nga marrësi i mallrave në Republikën e Shqipërisë pas lejimit në qarkullim të lirë, por jo më vonë se tre ditë nga kryerja e importimit. Në rastin e furnizimit nga jashtë të shërbimeve, blerësi vendas i shërbimeve që ka marrë një faturë elektronike nga jashtë shtetit, kryen procedurën e fiskalizimit brenda afatit të referuar në nenin 8, pika 3 e këtij ligji.*

**Koment për sqarim:** A është e detyrueshme që elementet e dokumentit të zhdoganimit të jenë në faturë?

A duhet që fatura për mallrat të cilat importohen në magazinë doganore të fiskalizohet?

### **➡ Neni 24: Faturë elektronike për pagesa pa para në dorë**

*4) Në rast të furnizimit të mallrave me transport, tatimpaguesi që lëshon faturë, sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të lëshojë një faturë elektronike dhe të zbatojë procedurën e fiskalizimit menjëherë përpara kryerjes së transportit të mallrave, dhe të printojë në letër kodin QR me të dhënat e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat, dhe t’ia dorëzojë atë transportuesit. Transportuesi duhet ta ruajë këtë dokument gjatë tërë kohëzgjatjes së transportit të mallrave, nga nisja deri në destinacion, ose deri sa t’ia dorëzojë mallrat blerësit dhe, detyrohet me kërkesën e zyrtarëve të administratës tatimore, ta vendosë këtë dokument në dispozicion të tyre.*

**Koment për sqarim:** Si veprohet në rastet kur QR nuk mundësohet dot nga sistemi për arsye të rënies së sistemit?

## ***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

***Sugjerim:*** Do të ishte i nevojshëm në parashikim për rastete kur QR nuk mundësohet dot nga sistemi për arsye të rënies së sistemit të tatimeve (psh ngarkesa në server, mungesë Interneti, etj).

***Koment për sqarim:*** Çfarë elementesh duhet të përmbajë dokumenti i transportit kur është i ndryshëm nga fatura?

Nëse një subjekt bën faturën në një moment të caktuar por mallin ia dërgon klientit në një ditë tjetër, si do të plotësohet transporti tek fatura?

### **➡ Neni 29: Ndërprerja e lidhjes elektronike (internetit)**

*m) Tatimpaguesi që lëshon fatura, duhet që brenda 48 orëve, duke filluar nga data e ndërprerjes së lidhjes, të vendosë një lidhje elektronike (interneti) dhe t’ia dorëzojë të gjitha faturat e lëshuara, sipas pikës 1, të këtij neni, administratës tatimore, nëpërmjet një protokolli të veçantë në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat, si dhe pranuesit të faturës elektronike në rastin e përmendur në nenet 24 dhe 25, të këtij ligji.*

***Koment për sqarim:*** Si do të veprohet në rastet kur është e pamundur të bëhet lidhja për 48 orë?

*7) Nëse tatimpaguesi që lëshon faturë nuk mundet që në afatin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, të rivendosë lidhjen elektronike (internet), për arsye të nevojës për të ndryshuar pajisjen për vendosjen e lidhjes elektronike (internet), pamundësisë për të vendosur lidhjen elektronike (internet) për të cilën është përgjegjës ofruesi i këtij shërbimi, ose për arsye të forcës madhore, ai duhet të njoftojë administratën tatimore për këtë, dhe të dërgojë dokumentacionin ose provat e tjera që dëshmojnë pamundësinë e vendosjes së lidhjes elektronike (internet), sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për financat.*

***Koment për sqarim:*** Çfarë do të konsiderohet si provë dhe cili do të jetë dokumentacioni që do shërbejë për praktikën në fjalë?

### **➡ Neni 30: Ndërprerja e punës së pajisjes fiskale për zbatimin e fiskalizimit**

*3) Në rastin e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, lëshuesi i faturës detyrohet që brenda pesë ditëve, pas ditës kur pajisja fiskale ka ndaluar plotësisht së funksionuari, të mundësojë funksionimin e pajisjes për lëshimin e faturave fiskale ose të sigurojë një pajisje të re.*

***Sugjerim:*** Sugjerojmë që të meren në konsideratë periudha prej dy javësh dhe jo pesë ditësh. Mund të ndodhë që pajisjet të mos jenë në dispozicion, duhen importuar etj.

### **➡ Neni 38: Limiti i arkës**

*2) Kriteret për përcaktimin e shumës së maksimumit të arkës së tatimpaguesit që lëshon faturë, janë madhësia e tatimpaguesit që lëshon faturë, në përputhje me legjislacionin tatimor. Bazuar në këtë kriter, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të caktojë shumën maksimale të parave kesh në arkë, në mënyrën e mëposhtme:*



## ***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

- a) *tatimpaguesit me qarkullim vjetor në vitin e kaluar deri në 2 milionë lekë deri në 50000 lekë;*
- b) *tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 2 milion deri në 14 milion lekë deri në 300000 lekë;*
- c) *tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milion lekë deri në 800 000 lekë.*

**Sugjerim:** Sugjerojmë shtimin e një niveli më të lartë xhiroje. Retailers të organizuar realizojnë shitje ditore për vlera mbi 3,000,000 lekë në ditë, madje në periudha sezonale festash, xhiro ditore mund të arrijë deri në 20,000,000 lekë në ditë.

Ne sugjerojmë që të ketë parashikime dhe për biznese me xhiro vjetore. Sigurisht interesi i biznesit është që pagesat të bëhen online, por derisa të ndërrojnë qasja ndaj pagesave do të krijohen shumë vështirësi operacionale.

Gjithashtu, ne sugjerojmë që për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tregtisë me pakicë dhe me xhiro mbi 100,000,000 lekë, limiti të jetë jo më shumë se 30% e xhiros. Ky propozim vjen duke marrë parasysh që ato operojnë dhe në fundjavë dhe është e pamundur që të depozitohen fondet në banka ditët e festave apo fundjavat.

- 6) *Tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet në fillim të çdo dite pune, dhe para lëshimit të faturës së parë, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur me administratën tatimore, lidhje të cilën e përdor për zbatimin e procedurës së fiskalizimit, të paraqesë informacionin mbi shumën fillestare të parave në dorë në arkë (depozitave), për çdo pajisje elektronike të faturimit, në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat.*

**Koment:** E pamundur për t’u realizuar para shitjes së parë për dyqanet me shumë kasa.

**Sugjerim:** Sugjerojmë që të bëhet një herë në muaj për ditën paraardhëse. Kontrollat të realizohen në bazë të librave të bankave e arkave. Realizimi i kësaj kërkesë imponon punësime shtesë si fuqi punëtore dhe si rrjedhojë do të sillte kosto shtesë për biznesin.

### **➡ Neni 39: Subjektet dhe procedurat për regjistrimin e pagesave pa para në dorë**

- 5) *Nëse subjektet sipas pikës 1, të këtij neni, nuk kanë në dispozicion të gjitha të dhënat e përmendura në pikën 4, të këtij neni, detyrohen të marrin këto të dhëna nga blerësi dhe, në atë rast, nuk kryejnë pagesën derisa blerësi të paraqesë të gjitha të dhënat e kërkuara.*

**Koment për sqarim:**

- A është e mundur të bëhen disa pagesa për një NIVF (pagesa pjesore fature)?
- A është e mundur të bëhet një pagesë TOT për disa NIVF njëherësh?
- A mund të kryhet pagesë për vlerë më të madhe se vlera e faturës?
- Si do të veprohet nëse subjekti ka për të paguar detyrime të mëhershme se data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk ka NIVF për të referuar?
- Si veprohet për rastet kur subjekti kalon fonde tek ortaku?



***Komente mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”***

- A mund të paguhet një furnitor i huaj që ka lëshuar fature Proformë?
  - Si kryhet pagesa?
- 7) Nëse ajo konstaton që nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikën 6, të këtij neni, administrata tatimore i kthen mesazh subjektit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, për regjistrimin e pasuksesshëm të pagesës së bashku me një shpjegim për gabimet, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internet). Nëse konstatohet ndonjë gabim si pasojë e fajit të ndërmjetësit financiar, ky detyrohet të korrigjojë gabimin dhe të përsërisë procedurën...

Koment për sqarim: A parashikon kjo një ndërhyrje të ndërmjetësit financiar (banka) në llogarinë e Klientit të tij pa dijeninë e klientit?